



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:251737

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589079

P.2021:251738

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, me procesmbajtësen Indira Beqa, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh.L, i akuzuar për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër me numër PP/IL.nr.1169/21, e datës 08.11.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më datë 12.03.2024, në praninë e Prokurorit së Shtetit Fatos Ajvazi, të pandehurit, mbrojtësit të tij – Avokat H.L., palës së dëmtuar N. K. dhe përfaqësuesit të tija Avokate E. H...- V., më datë 14.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 18.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: Xh.L nga Kaçaniku Rruga "..., i lindur më datë, ..., nga i ati M... dhe e ëma Xh... e gjinisë L..., me numër personal..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i 3 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 24.07.2021, rreth orës 17:30, në rrugën “Nevzat Çallaku”, në Kaçanik, i pandehuri më qëllim të frikësimit, ka kanosur seriozisht më fjalë të dëmtuari N. K., për shkak të një kontesti pronësor ne mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke pastruar rrugën nga disa shkurre që shpije deri tek shtëpia e tij dhe duke i larguar disa tela, kishte shkuar i pandehuri dhe fillimisht e fyer më fjalët “O qen, o pis ec se ta baj kerrin pikë pikë dhe mos gabo me prekë këtë pronë”, e me pastaj i’u drejtohet me fjalët kërcënuese “*Ta marrë shpirtin, deri nesër ki besë dhe mos gabo me prek pronën*”, me ç ‘rast palës së dëmtuar i ka shkaktuar ndjenjën e shqetësimit dhe frikës për jetën dhe trupin.

- Me të cilat veprime ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së

Andaj duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

I. Dënim me gjobë në shumë 600€ (Gjashtëqind euro), të cilin i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 3 këste të barabarta në afat prej 3 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën, dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara, nëse kësti nuk paguhet me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II. Pala e dëmtuar udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t’i paguaj kësaj gjykate shumën prej 30.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1169/2021 të datës 08.11.2021, kundër të pandehurit të lartë shënuar për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 12.03.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Pretendimet e palëve

Prokurori e shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare në formë të shkruar përpos tjerash ka deklaruar se pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësorë, vlerësoj se është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të kësaj aktakuzë. Nuk është kontestuese në mes të palëve se i pandehuri me palën e dëmtuar nnjihen mes vehte dhe janë fqinjë, nuk është kontestuese se i pandehuri me të dëmtuarin dhe familjën e tij kanë probleme pronësore, nuk është kontestuese në mes të palëve se i pandehuri dhe pala e dëmtuar janë takuar ditën kritke.

Se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza vërtetohet nga dëshmia e të dëmtuarit të dhënë në cilësinë e dëshmitarit – N. K., i cili e ka vërtetuar se ditën kritke deri sa ka qenë duke e pre një tel, aty është ofruar Xh. L., i cili i ka thënë “leje telin se nuk ban me prek” është larguar dhe i pandehuri ka shkuar përpjetë në drejtim të të dëmtuarit i cili i drejtohet me fjalët “ta marr shpirtin, je deri nesër në besë”, të cilën e ka konfirmuar edhe dëshmitari H.K.. Mbi këto prova ka deklaruar se në këtë rast formësohet të gjitha elementet e veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ti merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësue dhe rënduese.

- Përfaqësuesja e palës së dëmtuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare në formë të shkruar përpos tjerash ka deklaruar: Nga të gjitha provat e administruara është vërtetuar se i pandehuri më datë 24.07.2021 e kishte kanosur seriozisht të dëmtuarin me fjalët ta marr shpirtin, të jap besë deri nesër, me çka kishte shkaktuar frikë dhe pasiguri te i pandehuri, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe si rrethanë rënduese të merr faktin se i pandehuri është recidivist.

- Mbrojtësi i të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare në formë të shkruar përpos tjerash ka deklaruar: I ka kërkuar gjyktës që i pandehuri të lirohet nga akuza, se me asnjë provë të vetme relavante nuk janë vërtetuar pretendimet e prokurorisë, dhe atë akuza është mbështetur vetëm në një provë – dëshminë e palës së dëmtuar. I pandehuri fjalët të cilat i ka përdorur nuk ka pasur për qëllim frikësimin e palës së dëmtuar, por vetëm dhënia e një vërejtje për veprimet që i ka bërë i dëmtuari. Se pala e dëmtuar nuk ka qenë e kanosur vërtetohet edhe nga deklarata e të dëmtuarit të dhënë në Polici i cili ka deklaruar se nuk e ndien vehtën të kërcënuar, ndërsa në Prokurori dhe gjykatë e ka ndryshuar deklaratën.

- I pandehuri, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare e ka mohuar të ketë kanosur palën e dëmtuar, por ka deklaruar se të gjitha fjalët i ka thënë nën afekt dhe që mos të vie deri te ndonjë gjë më e madhe dhe i ka mbështetur fjalët e mbrojtësit të tijë.

Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

- Janë dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, i dëmtuari N. K.K. dhe H. K..

- Në fazën e administrimit të provave janë lexuar: -procesverbal i marrjes ne pyetje i te pandehurit i dhënë ne Prokurori, i datës 04.11.2021, -procesverbal i marrjes ne pyetje i te dëmtuarit i dhënë ne Prokurori, i datës 03.11.2021, -procesverbal i marrjes ne pyetje i dëshmitarit H.K, i dhënë ne Stacionin Policor ne Kaçanik, i dates 29.07.2021, - procesverbal i marrjes ne pyetje i te dëmtuarit i dhënë ne Stacionin Policor ne Kaçanik, i datës 28.07.2021, - procesverbal i marrjes ne pyetje i te pandehurit i dhënë ne Stacionin Policor ne Kaçanik, i datës 28.07.2021, -raporti fillestar i incidenti, i datës 24.07.2021, -deklarata e te dëmtuarit, e dhënë ne Stacionin Policor ne Kaçanik, date 24.07.2021, - deklarata e te pandehurit, e dhënë ne Stacionin Policor ne Kaçanik, date 24.07.2021, - deklarata e dëshmitarit H.K, e dhënë ne Stacionin Policor ne Kaçanik, date 24.07.2021, -marrëveshje ne forme te shkruar me dore, e datës 25.07.2021, dhe shikimi i një CD.

Nuk ka pasur pyetje në provat e administruara por ka pasur vërejtje nga përfaqësuesja e palës se dëmtuar, ka vërejtje lidhur me marrëveshjen per arsyeje se e njëjta është përpiluar nen presionin e kanosjes, kur M.K. babi i N. K., nen rrethanat e kanosjes se djalit te tij nga Xh. L.

dhe ate jo per here te pare e ka nënshkruar kete marrëveshje, duke u frikësuar se djalit te tij do te i ndodhë ndonjë e keqe nga tani i akuzuari Xh. L.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet:

Gjykata në bazë të provave të administruara në shqyrtim gjyqësor ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si në mënyrë, kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat që janë administruar gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor ku pas analizimit të të gjitha këtyre provave një nga një dhe të gjitha bashkërisht, ka ardhur në këto përfundime:

Faktet jo kontestuese të rastit:

- Nuk ishte kontestuese në mes palëve se i pandehuri me 24.07.2021, rreth orës 17:30, në rrugën “...” në Kaçanik, i pandehuri dhe i dëmtuari janë takuar në pronën kontestuese të tyre.
- Nuk ishte kontestuese në mes të palëve se i pandehuri dhe pala e dëmtuar (familja e tij) kanë kontest pronësor mes tyre, e cila është zhvilluar në Gjykatën Themelore Ferizaj Dega Kaçanik sipas numrit të lëndës C.nr.269/17.

Faktet kontestuese të vërtetuara:

Faktin se më datë 24.07.2021, rreth orës 17:30, në rrugën “Nevzat Qallaki” në Kaçanik i pandehuri, me dashje i ka shkaktuar frikë dhe ankth se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe – kundër jetës dhe trupit ndaj palës së dëmtuar, në atë mënyrë në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke pastruar rrugën nga disa shkurre që shpije deri tek shtëpia e tij dhe duke i larguar disa tela, kishte shkuar i pandehuri dhe fillimisht e fyen më fjalët “O qen, o pis ec se ta baj kerrin

pikë pikë dhe mos gabo me prekë këtë pronë”, e me pastaj i’u drejtohet me fjalët kërcënuese “Ta marrë shpirtin, deri nesër ki besë” ky fakt u vërtetua nga dëshmia e dëshmitarit – të dëmtuarit N. K.e dhënë në shqyrtim gjyqësor, i cili ka dëshmuar se i pandehuri i ka thënë “ta marr shpirtin, je deri nesër ne bese”,

Faktin se këto fjalë të pandehurit, palës së dëmtuar i ka shkaktuar frikë, ankth, shqetësim dhe pa siguri se do ta gjej ndonjë e keqe – lëndim trupor apo vdekje, këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga dëshmia e të dëmtuarit në shqyrtim gjyqësorë ku i njëjti ka deklaruar se prej asaj dite dhe sot unë dhe familja ime ndjehemi të frikësuar dhe kërcënuar nga i pandehuri, ku ka deklaruar se edhe sot (dita kur e ka dhënë dëshminë në shqyrtim gjyqësor) ndihet i kërënuar.

Gjykata dëshminë e dëshmitarit – të dëmtuarit e vlerësoi si të besueshme për arsye se e njëjta ishte konsistente dhe në përputhje me deklaratën e tijë të dhëna në Prokurori, po ashtu e njëjta ishte në përputhje edhe me video incizimin i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Po ashtu gjykata e analizoi edhe videoincizimin i cili është adminstruar si provë në shqyrtim gjyqësor (CD e cila gjendet në shkresat e lëndës) ku shihet dhe dëgjohe qartë se i pandehuri e kishte kërcënuar palën e dëmtuar me fjalët,” *“Ta marrë shpirtin, deri nesër ki besë”,* të cilën provë gjykata e ka vlerësuar si të pranueshme dhe e njëjta nuk ishte kundërshtuar dhe as nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga ana e mbrojtjes, përpos faktit që i pandehuri ka deklaruar se fjalët i ka thënë nën afekt.

Gjykata vlerësoi se i pandehuri këtë vepër e ka kryer me dashje, për shkak se palët kanë probleme pronësore mes vehte (fakt jo kontestues) dhe faktin se pala e dëmtuar në atë moment ishte duke vepruar- punuar pikërisht në atë pronë kur ka ndodhur ngjarja.

Gjykata e ka analizuar dhe vlerësuar edhe faktin se i pandehuri në deklaratën e dhënë në polici kishte deklaruar se nuk e dnien vehten të kërcënuar nga i pandehuri, ndërsa në Gjykatë dhe në deklartën e dhënë në prokurori ka deklaruar se është ndier dhe edhe tani ndihet i kërcënuar, por gjykata e ka marrë dhe vlerësuar si të besueshme përgjigjien e palës së dëmtuar i cili është sqaruar se: *“sepse kam pas kerkese prej vllaznive, sepse ata nuk donje me pas problem me te pandehuri, por une ndihem edhe sot i kërcënuar nga ai”*, duke u bazuar edhe në atë se palët kanë kontest pronësor mes tyre një kohë të gjatë, e cila për gjykatën nuk ishte relevante se cila

prej palëve e ka fituar apo jo pronësinë në atë pjesë, të drejtë të cilën palët janë duke e zgjidhur apo e kanë zgjidhur në kontest civil.

Analizimi dhe vlerësimi i provave tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor:

Gjykatata e analizoi dhe vlerësoi dëshminë e dëshmitarit H.K të dhënë në shqyrtim gjyqësor e po ashtu edhe - deklarata e dëshmitarit H.K, e dhënë ne Stacionin Policor ne Kaçanik, date 24.07.2021, procesverbal i marrjes ne pyetje i dëshmitarit H.K, i dhënë ne Stacionin Policor ne Kacanik, i dates 29.07.2021, nga dëshmia dhe deklaratat e këtij dëshmitari gjykata ka arritur si përfundim të nxjerr vetëm ato fakte të cilat janë jo kontestuese në mes të palëve.

Gjykata e ka analizuar dhe vlerësuar edhe marrëveshje ne forme te shkruar me dore, e datës 25.07.2021, por për gjykatën nuk ka pasur ndonjë vlerë provuese në raport me veprën penale dhe gjendjen faktike për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Vlerësimi i mbrojtjes së të pandehurit:

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e të pandehurit i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale, i cili përpos tjerash ka deklaruar se fjalët i ka thënë nën afekt duke mos dashur që të bëhet dqika më e madhe, këto pretendime gjykata nuk i mori për bazë, për arsye se i pandehuri nuk i mohuar fjalët e përshkruara në dispozitiv, si dhe për faktin se kanë probleme pronësore mes tyre, dhe arsyet tjera të përshkruara më lartë, ndërsa pretendimet e tjera nga i pandehuri nuk ishin të argumentuara me asnjë provë dhe të njëjtat kishin për qëllim fshehjen e veprimeve inkriminuese dhe ikjen nga përgjegjësia penale.

Elementet e veprës penale

Në nenin 181 paragrafi 2 parashihet: *Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet ..*

Gjykata vlerëson se me veprimet e të pandehurit plotësohen të gjitha elementet e veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, si në mënyrë, kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

- Vepra penale është kryer me dashje dhe e njëjta ka qenë serioze, sepse i pandehuri për shkak të problemeve të më hershme pronësore me palën e dëmtuar ka pasur motivin për kryerjen e kësaj vepre penale.

- Kjo vepër penale është kryer me fjalë, dhe fjalët , “*Ta marrë shpirtin, deri nesër ki besë*”, në rrethanat e rastit konkret dhe problemeve pronësore që kanë ndërmjet tyre i dëmtuari dhe i pandehuri, gjykata i ka vlerësuar se të njëjtat janë fjalë kërcënuese.

- Me këtë vepër penale për tu plotësuar figura e saj duhet të plotësohet edhe kushti që palës së dëmtuar me ato fjalë rrezikohet seriozisht se do t’i se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor me qëllim të frikësimit ose të shaktimit të ankthit. Ku në rastin konkret palës së dëmtuar i ka shkaktuar frikë, ankth, shqetësim dhe pa siguri se do t’i shkaktohet lëndimi i rëndë trupor apo vdekje, i cili element i veprës penale del nga vet fjalët kërcënuese “*Ta marrë shpirtin*” të cilin fakt Gjykata e ka vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit e dhënë në shqyrtim gjyqësorë dhe provae tjera të administruara si më lartë.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në këtë aspekt si rrethana lehtësuese Gjykata gjeti se i pandehuri është mbajtës i familjes dhe prind i 3 fëmijëve, i njëjti jeton në kushte të varfër ekonomike, ka qenë i provokuar nga pala e dëmtuar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se i pandehuri është recidivist, i dënuar më vendime të formës së prerë: P.nr.143/19 të datës 18.02.2016 dhe P.2020:063324 të datës 16.02.2023, për të cilat në shkresat e lëndës është vendosur Certifikata mbi dënimet penale të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës

penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, po ashtu bazuar edhe në faktin se dënimet e kushtëzuara në të kalurën nuk kanë pasur efekt tek i pandehuri.

Gjykata dënimin me gjobë shqiptoi duke u bazuar në të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi për udhëzimin në kontest civil të palës të dëmtuar është marrë në bazë të nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.2021:251738 datë 18.04.2024

Gjyqtari
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimet të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.